



REPUBLIKA E KOSOVËS
BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS
Islamic Community of Kosova
KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME NË VUSHTRRI



Rr: "Mic Sokoli", Vushtrri, Kosovë
Tel & fax: +381/ 028 571 213 & 570 681

www.kbi-vushtrri.com
kbi_vushtrri@yahoo.com

Nr. Protok. 201 /2010 Data: 02 /06 /2010

Këshilli i Bashkësisë Islame në Vushtrri, në mbledhjen e mbajtur me anëtarët e Këshillit me datë 22/02/2010, duke shqyrtuar ecurinë e punëve të Këshillit dhe duke diskutuar mbi mundësitë e reja të shërbimeve sa më cilësore të Këshillit, dhe pas dy diskutimeve në dy mbledhjet mujore me imamë (maj-qershor) solli këtë:

V E N D I M

Tash e tutje, respektivisht nga mbledhja mujore e muajit maj me imamë (11/5/2010), e me theks të veçantë nga mbledhja e qershorit (1/6/2010) ku u diskutua për herë të dytë vendimi, shërbimet fetare, mevludet dhe qelimet, të kryhen nëpërmjet Këshillit në mënyrë që të inkasohet anëtarësia edhe prej tyre.

Këshilli i BI-së, mbështetur në rregulloren mbi Sistematizimin e vendeve të punës, detyrave dhe punëve, respektivisht në Nenin 12, alineja 13, ku Imami obligohet të mbajë uniformën fetare gjatë shërbimeve, ka vendosur që të gjithë imamët t'i pajis me nga një *xhybe* dhe *shallë*, kështu që prej periudhës së lartcekur, nuk lejohet të kryhet asnjë shërbim fetar pa qenë paraprakisht me veshjen e obliguar fetare nga Këshilli.

Për *Mevlud* dhe *Qelime* obligative është vetëm Imami kryesor. Shërbimi është **50€**, prej të cilave Imamit i takojnë **40€** kurse **10€** mbesin në Këshill. Në rast se pala shpreh dëshirën e thirrjes së më shumë se një Imami, atëherë ai është i lirë të zgjedhë kë të dojë, vetëm se nëse dëshiron që pagesa të kryhet nëpërmjet Këshillit, atëherë çmimi i paraparë është **60€**, prej të cilave **10€** mbesin në Këshill kurse Imamit kryesor dhe Imamit shtesë iu takojnë nga **25€**.

Po kështu, është vendosur që edhe imamët shtesë të kryejnë shërbime fetare sipas një liste të përgatitur nga Këshilli. Më konkretisht, Imamët janë ndarë në tri regjione:

- Imamët e qytetit, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në shërbime shtesë në fshatra, vetëm në rast se ftohen më shumë se një Imam shtesë;
- Imamët e fshatrave të rrethit të Çyçavicës, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në shërbime shtesë në qytet dhe në fshatrat e regjionit tjetër, vetëm në rast se ftohen më shumë se një Imam shtesë;
- Imamët e fshatrave të rrafshit (Nedakovc e tutje), të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në shërbime shtesë në qytet dhe as në fshatrat e Çyçavicës, vetëm në rast se ftohen më shumë se një Imam shtesë;

Vërejtje:

1. Çdo shërbim varrimi që kryhet pa informuar Administratën, gjobitet –sipas Nenit 41-me ndalesë administrative prej 3 (tri) herë më tepër se shërbimi;
2. Shërbimet “mevlud dhe qelime” që kryhen pa lajmëruar Këshillin dënohen aq sa është përcaktuar shuma për to;
3. Shërbimet që kryhen pa uniformën fetare nuk paguhen.

Komisioni për verifikimin dhe kontrollimin e shkeljeve eventuale të këtij vendimi është i përbërë nga Kryeimami, Sekretari dhe Arkëtari. Pagesat e çdo shërbimi deponohen në konton e punëtorëve përkatës në fund të muajit.

Shënim: Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas mbledhjes mujore me Imamë.

KRYETARI,

Shemsi Rrahimi, prof.